



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE**

V E N D I M

PËR KTHIMIN PËR PLOTËSIM TË LISTËS SHUMEMËRORE TË KANDIDATËVE PËR ANËTARË NË KËSHILLIN E BASHKISË SHKODËR TË DEPOZITUARA NGA PARTIA "KRISTIAN DEMOKRATE" PËR ZGJEDHJET PËR ORGANET E QEVERISJES VENDORE TË DATËS 30 QERSHOR 2019

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve në mbledhjen e datës 17.05.2019, me pjesëmarrjen e:

Klement	ZGURI -	Kryetar
Denar	BIBA -	Zv.Kryetar
Bledar	SKËNDERI-	Anëtar
Edlira	JORGAQI-	Anëtare
Rezarta	BITRI-	Anëtare

Shqyrtoi çështjen me:

OBJEKT: Për kthimin për plotësim të listës shumëmemërore të kandidatëve për anëtarë në këshillin e Bashkisë Shkodër të depozituara nga Partia "Kristian Demokrate" për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 30 qershor 2019

BAZË LIGJORE: Neni 23, pika 1, germa a, neni 67, dhe 6 neni 72 dhe neni 73, pika 1, të Ligjit nr.10019, datë 29.12.2008 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë"

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve pasi shqyrtoi dokumentacionin e paraqitur nga Partia "Kristian Demokrate", si dhe dëgjoi diskutimet e përfaqësuesve të partive politike,

V Ë R E N:

Partia Kristian Demokrate, është regjistruar si subjekt zgjedhor për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 30 qershor 2019.



Nr. 499 i Vendimit

Data 17.05.2019

Ora 18:00 e Vendimit

Për kthimin për plotësim të listës shumëmemërore të kandidatëve për anëtarë në këshillin e Bashkisë Shkodër të depozituara nga Partia "Kristian Demokrate" për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 30 qershor 2019

Në bazë të nenit 67, dhe nenit 72, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë" i ndryshuar, Partia Kristian Demokrate ka paraqitur në KQZ dokumentacionin për miratimin e listave shumemërore.

Në mbledhjen e datës 17.05.2019 në bazë të nenit 73, të Kodit Zgjedhor, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve verifikoi listat shumemërore të kandidatëve për Anëtarë Këshilli të Partisë Kristian Demokrate dhe dokumentacionin bashkëngjitur të paraqitur dhe konstatoi mangësitë e dokumentacionit si më poshtë:

1. Deklarata e kandidatit me nr.rendor 19;
2. Certifikatë lindjeje/personale ose kopje e dokumentit të identifikimit për të gjithë kandidatët.

Në këto kushte KQZ duhet:

Të kthej për plotësim dokumentacionin e kandidimit, për korrigjimin e mangësive të konstatuar nga Partia "Kristian Demokrate".

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve mbështetur në nenin 23, pika 1, germa a, nenin 67, pikat 1, 4, 5, dhe 6, nenin 72, dhe nenin 73, pika 1 të Ligjit nr.10019, datë 29.12.2008 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar.

V E N D O S I:

1. Kthimin për plotësim të dokumentacionit për regjistrimin e listës shumemërore të kandidatëve për Anëtarë Këshilli të Bashkisë Shkodër, të Partisë Kristian Demokrate, për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 30 qershor 2019.
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.
3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Kolegjin Zgjedhor pranë Gjykatës së Apelit Tiranë, brenda 5 ditëve nga shpallja e tij.

Klement	ZGURI -	Kryetar
Denar	BIBA -	Zv.Kryetar
Bledar	SKËNDERI-	Anëtar
Edlira	JORGAQI-	Anëtare
Rezarta	BITRI-	Anëtare



Nr. 499 i Vendimit

Data 17.05.2019

Ora 18:00 e Vendimit

Për kthimin për plotësim të listës shumemërore të kandidatëve për anëtarë në këshillin e Bashkisë Shkodër të depozituara nga Partia "Kristian Demokrate" për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 30 qershor 2019